

RELACION
PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN
NR. 24/2017 “PËR ADMINISTRIMIN E UJITJES DHE TË KULLIMIT”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË
SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është që nëpërmjet disa ndryshimeve dhe shtesave në ligjin nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, të përmirësojë kuadrin institucional dhe ligjor për implementimin e politikës kombëtare për ujitjen, kullimin dhe mbrojtjen nga përmbytja.

Ndryshimet e propozuara në organizimin e strukturave në nivel qendror dhe rajonal, përgjegjëse për administrimin e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja, synojnë një ndarje të qartë të detyrave dhe përgjegjësi që lidhen me politikbërjen nga funksionet e operimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës, zbatimin efektiv të projekteve të reja të investimeve me impakt të madh si dhe përmirësimin e funksionimit dhe rritjen e kapaciteteve të nevojshme.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME
PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE
DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është hartuar në përputhje me programin e qeverisë, në të cilin parashikohet rritja e investimeve në sektorin e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet, si një nga faktorët kryesorë me ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e qëndrueshme të prodhimit bujqësor në vend.

Për arritjen e këtij objekti, si pjesë e një pakete masash, janë të nevojshme edhe përmirësimet strukturore dhe rritja e kapaciteteve dhe efektivitetit të strukturave implementuese, të cilat nuk mund të realizohen pa bërë disa ndryshime në ligjin ekzistues nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”.

Ky projektligj nuk është parashikuar në programin analitik të akteve të parashikuar për vitin 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, ka përcaktuar ministrinë përgjegjëse për bujqësinë, si organin kryesor përgjegjës për politikën e administrimit të ujitjes dhe kullimit.

Drejtoritë e ujitjes dhe kullimit, si struktura në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), aktualisht të organizuara në katër rajone, kanë për detyrë shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës kryesore të ujitjes dhe kullimit dhe veprat mbrojtëse nga përmbytjet në administrim të tyre, brenda zonave përkatëse të shërbimit.

Ndërsa, bashkitë shfrytëzojnë dhe mirëmbajnë infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit të transferuar në pronësi të tyre, brenda zonave përkatëse të shërbimit, në mënyrë që çdo fermer të marrë ujë në kohën dhe sasinë e kërkuar apo siguroar kullimin nëpërmjet pastrimit të kanaleve kullues.

Në këtë ligj, përcaktohen edhe detyrat e Organizatave të Përdorimit të Ujit, në rastet kur ato krijohen dhe funksionojnë për sigurimin e ujit për ujitje për anëtarët e tyre dhe bashkia përkatëse i transferon përgjegjësitë e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes.

Ndryshimet dhe shtesat e propozuara në këtë projektligj bazohen në nevojën për rritjen e kapaciteteve të strukturave implementuese të MBZHR-së, për identifikimin dhe zbatimin e projekteve të mëdha infrastukurore të natyrës rehabilituese apo ndërtimit të strukturave të reja në sistemet e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja.

Nga vlerësimet e bëra evidentohen një sërë problematikash si më poshtë:

Së pari, struktura përgjegjëse në MBZHR krahas funksioneve të politikbërjes dhe atyre rregullatore (hartimi i politikave, strategjive, akteve ligjore dhe nenligjore përkatëse dhe ndjekja e zbatimit të tyre), hartimit të programeve mbështetës etj është e angazhuar edhe me detyra të tjera si koordinimi i veprimtarive me strukturat e varësisë dhe bashkitë, kryerja e kontrolleve teknike e fizike të infrastukturës, aktivitete specifike monitorimi etj.

Së dyti, MBZHR prej disa vitesh shërben drejtpërdrejt si agjenci implementuese e projekteve që realizohen me financim të huaj si Banka Botërore etj, kryesisht në rehabilitimin e sistemeve ujitëse. Këto projekte, për natyrën specifike të tyre kërkojnë stafe dhe kapacitete më të mëdha dhe për këtë arsye në menaxhimin e kontratave të ndryshme të tyre janë përfshirë disa njësi nga struktura të ministrisë dhe institucione të varësisë, por koordinimi i tyre në disa raste nuk ka rezultuar efektiv. Për shkak të nevojave të mëdha për financime, parashikohet që projekte të tilla do të vazhdojnë edhe në të ardhmen.

Së treti, përmbytjet po bëhen një fenomen i shpeshtë dhe harta e tyre është zgjeruar në disa zona problematike të vendit, duke shkaktuar në mjaft raste edhe dëme të konsiderueshme në bujqësi dhe blegtori apo edhe në aktivitete të tjera ekonomike në zonat rurale.

Për minimizimin e tyre, krahas të tjerash, është e domosdoshme të kryhen sa më parë studime fisibiliteti, përgatitja e projekteve të zbatimit si dhe realizimi i investimeve të mëdha për rehabilitimin e veprave mbrojtëse ekzistuese apo ndërtimin e veprave të reja.

Së katërti, Drejtoritë Rajonale të Ujitjes dhe Kullimit aktualisht kanë në fokusin e veprimtarive të tyre kryesisht operimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës kryesore në administrim, por jo kapacitetin e duhur për zbatimin e projekteve të tilla të mëdha dhe me natyrë komplekse.

Infrastruktura kryesore në administrim të tyre aktualisht përfshin:

- 22 kanale kryesore të ujitjes të skemave ujitëse që mbulojnë më shumë se një bashki, me gjatesi totale 1200 km, që mundësojnë furnizimin me ujë të një rrjeti sekondar kanalesh ujitëse në një sipërfaqe prej rreth 120 000 ha;
- 3400 km kanale kryesore kullues/kanale të ujërave të larta, që i shërbejnë një sipërfaqe prej 280 000 ha, ku i gjithë rrjeti sekondar administrohet nga bashkitë;
- rreth 850 km argjinatura të mbrojtjes nga përmbytjet;
- 27 hidrovoreve që kullojnë rreth 70 000 ha;
- 7 rezervuarë të mëdhenj për ujitje me një kapacitet të projektuar ujembledhës rreth 130 milion m³ ujë, ose rreth 35% e kapacitetit të projektuar të 619 rezervuareve të tjerë transferuar bashkive.
- Gjithashtu 4 drejtorite rajonale kanë në administrim 25 ekskavatorë krahë gjatë dhe 4 draga të posaçme për punime pastrimi të kanaleve kryesore ujites e kullues, kanaleve të ujërave të larta, lumenjeve, që shërbejnë si kolektorë kullues dhe pastrimin e grykederdhjeve të tyre në det.

Së pesti, me organizimin aktual, studimi dhe projektimi i veprave ujore është detyrë dhe përgjegjësi e një Sektori të veçantë, pranë Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqesore Fushë Krujë, institucion varësie i MBZHR, që disponon e mirëmban edhe arshivën e projekteve, por bashkëveprimi i tij me strukturat e tjera të administrimit të ujërave, jo gjithmone ka rezultuar efektiv.

Adresimi i çështjeve të mësipërme bën të nevojshme krijimin e një Agjencie të vetme të Ujitjes dhe Kullimit, në detyrat dhe përgjegjësitë e të cilës përfshihen jo vetëm detyrat ekzistuese të Drejtorive Rajonale të Ujitjes dhe Kullimit, por edhe disa detyra të tjera, të ushtruara deri tani nga struktura përgjegjëse në MBZHR si dhe detyrat që lidhen me studimin dhe projektimin e veprave ujore.

Përqëndrimi në një strukturë të këtyre funksioneve vlerësohet se do të sjellë një përdorim më të mirë të burimeve në dispozicion, rritjen e kapaciteteve për identifikimin dhe zbatimin më të mirë të projekteve prioritare dhe përmirësimin e menaxhimit dhe performancës.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën edhe legjislacionin e vendit, në fuqi.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk ka përafrim me legjislacionin e BE-së

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ndryshimet dhe shtesat në ligjin nr. 24/2017, datë 9.3.2017, “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, propozohen të bëhen në nenet specifike, si më poshtë :

Nenet 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8, 9, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 22, 23 dhe 24, të projektligjit parashikojnë ndryshimet respektivisht të neneve, 2, 5, 7, 8, 9, 10, 11, 15, 20, 27, 32,40, 41, 42, 44, 45 dhe 46, të ligjit, ku emërtimi i Drejtorisë së ujitjes dhe kullimit zëvendësohet me emërtimin e Agjencisë së ujitjes dhe kullimit.

Ky ndryshim bëhet pasi funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Drejtorive të ujitjes dhe kullimit i kalojnë Agjencisë së ujitjes dhe kullimit.

Neni 4 i projektligjit parashikon ndryshime të nenit 6 “Detyrat dhe përgjegjësitë e ministrisë”, pasi detyrat dhe përgjegjësitë, të përcaktuara në shkronjat “d”, “ë” dhe “f”, të pikës 1, të këtij neni, hiqen dhe i shtohen nenit 13 të ligjit “Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Agjencisë së ujitjes dhe kullimit”.

Neni 11 i projektligjit parashikon ndryshimin e nenit 12 “Krijimi i drejtorive të ujitjes dhe të kullimit”, me formulimin si më poshtë:

“Neni 12

Krijimi i Agjencisë së ujitjes dhe kullimit

1. Agjencia e ujitjes dhe kullimit krijohet si strukturë në varësi të ministrisë, si person juridik publik, që ka për qëllim të kryejë detyrat e parashikuara në këtë ligj.
2. Agjencia e ujitjes dhe kullimit krijohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të ministrit.
3. Vendimi i Këshillit të Ministrave për krijimin e Agjencisë së ujitjes dhe kullimit përcakton:
 - a) organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së ujitjes dhe kullimit;
 - b) vendndodhjen;
 - c) detyra dhe përgjegjësi specifike, përveç sa përcaktohet në nenin 13 të këtij ligji.
4. Agjencia e ujitjes dhe kullimit financohet nga Buxheti i Shtetit.”.

Ndryshimet në këtë nen bëhen, pasi në vend të Drejtorive të ujitjes dhe të kullimit, krijohet Agjencia e ujitjes dhe kullimit si dhe hiqet shkronja “b” e pikës 3, që përcakton zonat e shërbimit për drejtoritë, dhe me krijimin e Agjencisë ky përcaktim bëhet i panevojshëm, pasi veprimtaria e saj shtrihet në të gjithë territorin e vendit.

Neni 12 i projektligjit parashikon ndryshimin e nenit 13 “Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të drejtorisë së ujitjes dhe të kullimit”, ku përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Agjencisë së ujitjes dhe kullimit, duke përfshirë edhe detyrat e përcaktuara në shkronjat shkronjat “d”, “e” dhe “f” të nenit 6 të ligjit.

Neni 13 i projektligjit parashikon ndryshimin e nenit 14 “Organizimi i drejtorisë të ujitjes dhe të kullimit”, dhe rregullon marrëdhëniet e punës të nëpunësve të Agjencisë në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

Po kështu, neni 18 i projektligjit, parashikon ndryshimin e nenit 40 të ligjit, “Regjistrat”, duke zëvendësuar në pikën 1, shkronja “a”, fjalët “zonën nën shërbimin e ujitjes dhe të kullimit” me fjalët “infrastrukturën e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja në administrim”. Kjo për arsye se për Agjencinë, ky përcaktim bëhet i panevojshëm, sepse veprimtaria e saj shtrihet në të gjithë

territorin e vendit dhe zëvendësohet me termin specific “infrastrukturë”, çka nënkupton objektet në administrim të saj.

I njëjti argumentim vlen edhe për ndryshimin e propozuar në pikën 2, të nenit 43 të ligjit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Në zbatim të këtij ligji ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të nxjerrin aktet nënligjore. Ndërsa institucionet e ngarkuara për zbatimin e detyrave që përcaktohen në dispozitat e tij përfshijnë MBZHR dhe Agjencinë e Ujitjes dhe Kullimit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural në MBZHR.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i këtij projektligji nuk ka efekt financiar shtesë për buxhetin e shtetit. Shpenzimet për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë së Ujitjes dhe Kullimit, janë të parashikuar brenda tavaneve buxhetore për MBZHR për vitin 2018.

MINISTRI

Niko Peleshi